



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 01 Prot.

Tiranë, më 19/12/2018

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Sot, më 19/12/2018, ora 11, në sallën e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u mbajt ky procesverbal për të dokumentuar Mbledhjen e parë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas rendit të ditës të përcaktuar në përputhje me nenin 149 pika 9, 179, pika 6, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 280, 157 pika 1 dhe 279 pika 7, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Mbledhja u drejtua nga anëtari jomagjistrat më i vjetër në moshë i zgjedhur nga Kuvendi, Znj.Nurihan Seiti, në përputhje me nenin 280 pika të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

Të pranishëm në mbledhje ishin, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

1. Z.Alfred Balla
2. Znj.Antoneta Sevdari
3. Z.Arben Dollapaj
4. Z.Besnik Cani
5. Z.Bujar Sheshi
6. Z.Gent Ibrahimimi
7. Z.Gentjan Osmani
8. Z.Kostaq Beluri
9. Znj.Nurihan Seiti
10. Z.Sander Beci
11. Z.Tartar Bazaj

Të pranishëm, në mbledhjen e parë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë përfaqësues të OPDAT, përfaqësues të EURALIUS, Znj. Arta Marku , Prokurore e Pergjithshme

Mbledhja u monitorua nga te gjitha mediat.

Fjala e Hapjes nga Drejtuesja e mbledhjes znj. Nurihan Seiti.

Hapet diskutimi për pikën e parë të rendit të ditës.

- Miratimi i Rregullores për zgjedhjen e kryetarit dhe zv/kryetarit të KLP.
- Votimi i Kryetarit të KLP. U vetkandiduan z. Gent Ibrahimi dhe znj. Nurihan Seiti,

Pas votimit të gjithë anëtarëve të KLP u arrit ky rezultat.

Z. Gent Ibrahimi me **7 vota** dhe znj. Nurihan Seiti me **4 vota**.

Në përfundim u zgjodh **Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahimi**.

Fjala e zotit Ibrahimi si Kryetar Këshillit të Lartë të Prokurorisë .

- Hapja e procedurës për zgjedhjen e Zv. Kryetarit të KLP-se.

Kandidatet: z. Alfred Balla, znj. Nurihan Seiti dhe z. Tartar Bazaj

Votimi nga anëtarët.

Z. Alfred Balla **7 vota**

Pas Rezultatit të Z. Balla nuk u pa e nevojshme vazhdimi i votimit për kandidatet e tjere.

Kështu që zv/kryetar i Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë u caktua Z. Alfred Balla.

- Me pas u vazhdua sipas rendit të ditës me miratimin e Vendimit deklarativ për Krijimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Miratimi i rregullores “për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të lartë të prokurorisë të cilët do të kenë mandat tre vjeçar”.
- Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të lartë të prokurorisë të cilët do të kenë mandat tre vjeçar.

Perfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë në dispozicion të organizimit logjistik të shortit për :

- Perzgjedhja e anëtarëve jo prokurorë

Në një mbajtëse transparente u futën 5 gogla të njëjta, aq sa është edhe numri i kandidatëve, pjesëmarrës në short. Në dy prej goglave u fut një shirit letre ku shkruhet teksti “tre vjet” dhe në tre prej goglave u fut një shirit letre ku shkruhet teksti “pesë vjet”;

U ftuan anëtarët jo prokurorë të këshillit të renditur sipas rendit alfabetik të tërheqin, me rradhë nga një gogël. Secili nga anëtarët jo prokurorë pasi terhoqi goglën, e hapi e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë pjesëmarrësve dhe nga kjo përzgjedhje me short rezultoi se:

1. Alfred Balla, ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**5 vjet**”,
2. Genti Ibrahimimi ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**3 vjet**”,
3. Nurihan Seiti, ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**5 vjet.**”,
4. Sandër Beci, ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**3 vjet.**”,
5. Tartar Bazaj, ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**5 vjet**”,

➤ Perzgjedhja e anëtarit nga prokuroria e apelit

Në një mbajtëse transparente u futen 2 gogla të njëjta, aq sa është edhe numri i kandidatëve, pjesëmarrës në short. Në njërin prej goglave futet një shirit letre ku shkruhet teksti “**tre vjet**” dhe në gogëlën tjetër futet një shirit letre ku shkruhet teksti “**pesë vjet**”; Ftohen anëtarët e këshillit që vijnë nga prokuroritë e apelit sipas rendit alfabetik të tërheqin, me rradhë nga një gogël. Secili nga anëtarët pasi terhoqi gogëlën, e hap e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë pjesëmarrësve dhe nga kjo përzgjedhje me short rezultoi se:

1. Arben Dollapaj, ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**3 vjet**”,
2. Bujar Sheshi ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**5 vjet**”.

➤ Perzgjedhja e anëtarit nga prokuroria e shkallës së parë

Në një mbajtëse transparente futen 3 gogla të njëjta, aq sa është edhe numri i kandidatëve, pjesëmarrës në short. Në njërin prej goglave futet një shirit letre ku shkruhet teksti “**tre vjet**” dhe në dy goglat e tjera futet një shirit letre ku shkruhet teksti “**pesë vjet**”;


Ftohen anëtarët e këshillit që vijnë nga prokuroritë e shkallës së parë sipas rendit alfabetik të tërheqin, me rradhë nga një gogël. Secili nga anëtarët pasi terheq gogëlën, e hap e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë pjesëmarrësve dhe nga kjo përzgjedhje me short rezultoi se:

1. Antoneta Sevdari, ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**3 vjet**”,
2. Besnik Cani ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**5 vjet**”;
3. Gentjan Osmanaj ka perzgjedhur një gogel brenda të cilës është shënuar teksti “**5 vjet**”

Pas përfundimit të rendit të ditës, Mbledhja e Parë e Këshillit të Prokurorisë u konsiderua e mbyllur.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI



GENT IBRAHIMI


ZV/KRYETARI



ALFRED BALLA


ANETARËT

ANTONETA SEVDARI




BESNIK CANI


NURIHAN SEITI



ARBEN DOLLAPAJ




GENTJAN OSMANI



SANDËR BECI



BUJAR SHESHI



KOSTAQ BELURI



TARTAR BAZAJ



Mbajtës i procesverbal

MERITA CIKA

